



Pranuar / Received	Datë / Date	702	3	viti / year
Organ / Org. / Unit	Nr. Pror / Pr. No.	Shkup / Part / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity	
SKPM/SHCK	6198/2023		1/3	



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A nr.1065/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë me Rushit Kajtazi - Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, duke vepruar sipas ankesës me numër A.nr.1065/2023 të datës 08.08.2023 të parashtruar nga ankuesja në çështjen juridike “Kompensim material”, në mbështetje me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 22.09.2023, mori këtë:

### V E N D I M

Hedhet poshtë si e papranueshme ankesa me numër A.nr.1065/2023 e datës 08.08.2023 e parashtruar nga ankuesja

### A r s y e t i m

(tani e tutje referuar si ankuesja), e punësuar në Gjykatën Themelore në Gjilan, në pozitën e punës Shefe e Zyrës për Menaxhimin e Lëndëve, më datë 08.08.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5580 të regjistruar nën shenjen A.nr.1065/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të organit të punësimit, gjegjësisht Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (tani e tutje referuar si SKGJK), me pretendimin që të urdhërohet Këshillit Gjyqësor i Kosovës për shqyrtimin e Kërkesës të datës 26.05.2023 të parashtruar nga e njëjta në lidhje me kompensimin retroaktiv të diferencës së pagës nga koeficienti i përcaktuar nëntë (9), në koeficientin trembëdhjetë (13), nga dita e nënshkrimit të aktit të emërimit me datë 28.12.2012 e deri me datë 18.01.2023 si datë e nxjerrjes së Vendimit nga KGJK - Nr.01/2023 për Klasifikimin e vendeve të punës për të punësuarit në gjyqësor.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 09.08.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankese të SKGJK, ndërsa me datë 10.08.2023, nga kjo e fundit ka pranuar përgjigjen në ankese se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova:* Ankesën A.nr.1065 të datës 08.08.2023; Kërkesën e datës 26.05.2023, drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Akt Emërimin me numër reference 03-112-311 të datës 28.12.2012; Kontraten e marrëdhënies së punës të datës 25.10.2010; Vendimin A.nr.453/2023 të datës 18.04.2023; Vendimin KGJK - Nr.366/2017; Akt Emërimin 03-185 të datës 07.04.2014; Përshkrimin e Detyrave të Punës; Listën e pagave të muajit janar dhe shkurt 2023; Njoftimin e datës 05.08.2023; Vendimin KGJK Nr.01/2023; Përgjigjen në ankese me numër protokolli 1065/2023 të datës 10.08.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale lidhur me këtë çështja ankimore, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore që ankesa A.nr.1065/2023 e datës 08.08.2023 të **hedhet poshtë si e papranueshme, sepse:**

Ankuesja me datën 26.05.2023 i është drejtuar me kërkesë Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për kompensimin retroaktiv të diferencës së pagës nga koeficienti i përcaktuar nëntë (9), në koeficientin trembëdhjetë (13), nga dita e nënshkrimit të aktit të emërimit me datë 28.12.2012 e deri me datë 18.01.2023, datë kjo e nxjerrjes së vendimit nga KGJK Nr.01/2023 për Klasifikimin e vendeve të punës për të punësuarit në gjyqësor.

Rrjedhimisht, ankuesja me datë 05.06.2023, nga organi përkatës i punësimit, gjegjësisht U.d. Drejtori i Departamentit të Administratës së Përgjithshme, ka pranuar përgjigjen me shkrim në lidhje me kërkesën e datës 26.05.2023 (pranuar nga organi i punësimit me datë 31.05.2023) dhe njëkohësisht e njëjta është udhëzuar për ushtrimin e mjeteve juridike në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave brenda organit përkatës të punësimit, gjegjësisht SKGJK.

Tutje, nga shkresat e lëndës rrjedh se pala ankuese pas pranimit të përgjigjes me datë 05.06.2023 nuk ka vijuar me ushtrimin e mjeteve juridike në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në SKGJK, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e nenit 81 paragrafi 1 dhe 2 të Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dispozita këto të aplikueshme në rrethanat e rastit konkret, ngase me Aktgjykimin në rastin KO203/19 të Gjykatës Kushtetuese është konstatuar se neni 2 paragrafi 3 (fusha e zbatimit) dhe neni 85 i Ligjit Nr.06/114 për Zyrtarët Publikë, nuk janë në pajtueshmëri me nenin 108 (Këshilli Gjyqësor i Kosovës) dhe për pasojë në kuptim të menaxhimit të shërbimit civil në Sistemin Gjyqësor të Kosovës ka mbetur në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil.

Andaj duke marr parasysh se me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, perkatesisht nenit 81 është përcaktuar se: *1. Organe të veçanta për zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave në shërbimin civil do të themelohen në kuadër të secilit institucion të administratës qendrore dhe komunale, që ka nëpunës civilë. 2. Procedurat për zgjidhjen e kontesteve*




dhe ankesave zhvillohen nga këto organe: 2.1. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, dhe meqenëse nga shkresat e lëndës rezultojnë se ankuesja nuk ka vijuar me ushtrimin e mjeteve juridike fillimisht në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në SKGJK, Kolegji i Këshillit konstaton se e njëjta ka vepruar në kundërshtim me dispozitat përkatëse ligjore, ngase pas pranimit të përgjigjes me datë 05.06.2023, nga U.d Drejtori i Departamentit të Administratës së Përgjithshme, e njëjta është dashur që të ushtroj fillimisht ankesë të brendshme në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave pranë SKGJK, e pastaj të vijoj me ushtrimin e mjeteve juridike në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Andaj, për sa me sipër, dhe duke ju referua Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përkatësisht nenit 16 paragrafit 4 me të cilin është përcaktuar se: *Para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t'i ketë shterur procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit*, si dhe në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit konstatoi se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që ankesa me numër A.nr.1065/2023 e datës 08.08.2023 të hedh poshtë si e papranueshme.

Kështu që duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër: A nr.1065/2023**

**Rushit Kajtazi**  
  
Procesmbajtës

**Jeton Koca**  
  
Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankueses,
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

